

RAPORTI I *monitorimit* PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 3

(periudha e raportimit:
maj-korrik 2017)

Shkup, Gusht 2017

Projekti:

Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim është hartuar në kuadër të Projektit: “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë”, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë britanike.

Përmbajtja

Rezume e shkurtër – monitorimi i Këshillit Gjyqësor të RM – periudha maj – korrik 2017	4
Rezume e shkurtër – monitorimi i Këshillit për Përcaktimin e Fakteve – periudha maj – korrik 2017.....	5
Hyrje.....	6
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM	7
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e siguar ndaj publikut të gjerë.....	7
Llogaridhënia e siguar ndaj publikut të gjerë.....	9
Transparenca dhe llogaridhënia e siguar përmes mbajtjes së mbledhjeve	10
Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	13
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KGJRM.....	15
Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve	15
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.....	15
Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.....	16
Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë	17
Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve	18
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT	20
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguar ndaj publikut të gjerë	20
Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë	20
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FAKTEVE.....	22
Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura.....	22
Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve.....	22

Rezyme e shkurtër – monitorimi i KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM (periudha maj – korrik 2017)

Gjatë periudhës maj – korrik 2017 Këshilli Gjyqësor:

- Ka mbajtur 8 mbledhje
- Disa pika të rendit të ditës gjatë këtyre 3 muajve nuk ishin të hapura për publikun, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e punës së kryetarëve të gjykatave dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve. Në këtë periudhë u mbajtën mbledhje edhe sa u përket kërkesave të paraqitura nga ana e gjyqtarëve për përsëritjen e vlerësimit të punës së tyre dhe në këtë rast mbledhjet ishin të mbyllura për publikun.
- Këshilli Gjyqësor i RM gjatë kësaj periudhe ka zgjedhur kryetarë të gjykatave të: Gjykatës Themelore (GJTH) Gjevgjeli, GJTH Shën Nikollë, Gjykata Administrative, GJTH Krushevë dhe Ushtrues detyre – Kryetar i Gjykatës Themelore Resnjë.

Për të gjitha pozicionet u shpall edhe konkurs. Nuk u zgjodh vetëm kryetari i ri Gjykatës Themelore të Kumanovës meqë kandidatët nuk e fituan shumicën e nevojshme të votave nga anëtarët e KGJRM. Për mos zgjedhjen nuk kishte arsyetim.

- Në këtë periudhë Këshilli Gjyqësor shpalli konkurs për zgjedhjen e kryetarëve të këtyre gjykatave: *Gjykata e Apelit Shtip; Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup; Gjykata Themelore Kumanovë; Gjykata Themelore Tetovë; Gjykata Themelore Dibër dhe Gjykata Themelore Resnjë.*
- Këshilli Gjyqësor Raportin për vitin 2016 ia paraqiti Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në korrik të vitit 2017.

Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor:

Rekomandohet portali www.sud.mk, në pjesën për Këshillin Gjyqësor të RM, të plotësohet në të gjitha fushat me informacione relevante të cilat do të jenë lehtësisht të aksesshme, ndërsa dokumentet të radhitën sipas datës së publikimit.

Këshilli Gjyqësor duhet të mbaj llogari që gjyqtari, i cili zgjidhet për gjykatë më të lartë ose si kryetar i gjykatës, të promovoj standarde të larta të sjelljes së gjyqtarit, me qëllim që të fuqizohet besimi i publikut ndaj gjyqësorit i cili është element thelbësor për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Rezyme e shkurtër – monitorimi i KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE (periudha maj - korrik 2017)

- Numri i përgjithshëm i parashtrësive të paraqitura nga ana e qytetarëve, personave juridikë deri te Këshilli i Fakteve: 115
- Mbledhje të mbajtura të Këshillit të Fakteve në të cilat janë shqyrtuar parashtrësia e paraqitura: 14
- Kërkesa për ngritjen e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor i RM: 2

Aktivite sipas zërit të dëgjuar: Gjatë kësaj periudhe, iniciativat u iniciuan nga Këshilli i fakteve nga zëri i arritur dhe ka marrë informata, por për asnjë nga këto raste nuk u inicua procedura para Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

Hyrje

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, sipas ligjit, është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i cili e siguron dhe garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kompetencat, mënyra dhe procedurat e punës së Këshillit Gjyqësor të RM janë rregulluar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë¹ dhe me Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të RM.² Disa nga kompetencat të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në realizimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor të cilat janë objekt i monitorimit, janë: zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, vlerësimi dhe monitorimi i punës së gjyqtarëve, shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave dhe ngjashëm.

Në sistemin e jurisprudencës së RM, nga viti 2015, krahas Këshillit Gjyqësor ekziston edhe Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve) deri te i cili qytetarët mund të paraqesin parashtesë për parregullshmëritë në punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave ose për zvarritjen tejmase të procedurave gjyqësore.

Instituti për të Drejtat e Njeriut e implementon Projektin *“Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM”* i cili ka filluar në shtator të vitit 2016 dhe i cili ka mbështetje nga Ambasada e Britanisë në Shkup.³

Ky është **raporti i tretë i monitorimit** në kuadër të Projektit, i cili e përfshinë periudhën kohore nga muaji **maj deri në muajin korrik të vitit 2017**. Raporti i monitorimit për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit të Fakteve është përpiluar në bazë të Matricës së monitorimit të indikatorëve të përcaktuar.⁴

1 Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/06, 150/10 dhe 100/11.

2 Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor, “Gazeta Zyrtare” nr. 142, nga data 22.11.2009

3 Më shumë informacione për aktivitetet e Projektit janë të aksesshme në internet faqen e institutit për të Drejtat e Njeriut - www.ihr.org.mk, si dhe përmes aplikacionit mobil *“Këshilli Gjyqësor nën thjerrëz”* – i aksesshëm në Google Play dhe Apple Store.

4 Metodologjia e monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. E aksesshme në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=182>.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

√=e përbushur

x= e pa përbushur

√x= pjesërisht e përbushur

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor					
Karakteristika të përgjithshme	I qartë	I lehtë për navigacion	Ka përplot të dhëna relevante	I sistematizuar	I thjeshtë për kërkim
Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të RM-së www.ssrn.com.mk është zëvendësuar plotësisht me ueb-faqen e re www.sud.mk e cila e paraqet platformën e integruar të gjyqësorit	√x	x	x	√x	x
Akte të cilat publikohen	Publikimi në kohë	Arkiv i aksesshëm (i lehtë për përdorim dhe kërkim)	Azhurnimi i të dhënave	Akte/të dhëna të publikuara të plota	Vërejtje të përgjithshme
Vendime	√	x	√	X√	Vendimet për zgjedhje publikohen në ueb-faqen, por të njëjtat janë vështirë të aksesshme, meqë publikimet më të reja janë në faqen e fundit, ndërsa ato më të vjetrat janë në fillim.
Procesverbale	X	X	X	X	Procesverbalet e mbledhjeve nuk publikohen
Komunikata për mbledhjet e konvokuara	√x	√	√	√x	Komunikatat për mbledhjet e konvokuara rregullisht publikohen në faqen e re të internetit www.sud.mk në pjesën "Këshilli Gjyqësor"
Prokurime publike, informacione për publikun	√x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor nuk e ka azhurnuar listën e prokurimeve publike. Lista e prokurimeve publike për vitin 2016 është e aksesshme në një dokument në pjesën "risi".
Raporte vjetore të Këshillit Gjyqësor	x	x√	x√	x	Këshilli Gjyqësor i RM me vonesë e publikoi Raportin për punën e tyre për vitin 2016.
Raporte tremujore për punën e gjykatave në RM	x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor, rregullisht, në çdo tre muaj i shqyrton dhe vlerëson raportet. Megjithatë, të njëjtit nuk janë të aksesshëm në faqen e internetit, edhe pse është siguruar fusha për këtë dedikim

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë			
	A posedon KGJRM rregulla për komunikim me publikun		A ka person të angazhuar për t'iu përgjigjur kërkesave konform qasjes së lirë deri te informacionet
	√		√
Informimi proaktiv i publikut	Të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor	Publikime të shpeshtuara	Vërejtje të përgjithshme
Pres-konferenca	x	x	Në këtë periudhë Këshilli Gjyqësor nuk ka mbajtur pres-konferenca
Komunikata	√x	1 herë në javë	Komunikatat më së shpeshti kanë të bëjnë me mbajtjen e mbledhjeve dhe komunikata në lidhje me vendimet dhe konkluzionet nga mbledhjet e mbajtura
Intervista	x	1 herë në javë	Pas mbledhjeve, nëse ka gazetarë, Kryetari i KGJRM jep deklaratë dhe u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve.

Informacionet publikohen në faqen e internetit www.sud.mk e cila është ueb-platformë e integruar e të gjitha gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor të RM. Edhe pse ekziston tanimë një periudhë të gjatë kohore, dokumentet e faqes së vjetër të internetit akoma nuk janë bartur. Faqja e internetit përmban një pjesë të madhe të fushave të nevojshme, si për shembull: komunikata, raporte vjetore, prokurime publike dhe ngjashëm. Megjithatë, një pjesë e madhe e këtyre fushave janë të zbrazëta ose nuk azhurnohen rregullisht. Navigacioni nga njëra në fushën tjetër është i vështirësuar. Kërkimi i dokumenteve nuk është sistematizuar.

Komunikatat për mbajtjen e mbledhjeve dhe komunikatat për konkluzionet nga mbledhjet e mbajtura azhurnohen rregullisht në faqen e internetit. Megjithatë, komunikatat nuk përmbajnë informacione të detajuara për mbledhjen, por vetëm theksohen pikat e rendit të ditës për të cilat është votuar.

Fushat për raportet tremujore të punës së gjykatave, për prokurimet publike dhe për informatat për publikun nuk janë plotësuar fare.

Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve

Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve			
Transparenca e mbledhjeve	Numri i mbledhjeve të mbajtura	Pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë objekt diskutimi	Rrethanat në të cilat është përjashtuar publiku
Maj	3	<p>-Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e parë të vitit 2017;</p> <p>-Zgjedhja e gjyqtarëve – porotë të Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup;</p> <p>-Ndërprerja e funksionit të gjyqtarëve-porotë në Gjykatën Themelore Ohër, sipas propozimit të kryetarit të gjykatës për shkak të skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur.</p> <p>-Përcaktimi i Ushtresit të detyrës-Kryetar i Gjykatës Themelore Shën Nikollë.</p> <p>-Vlerësimi i rregullt i punës së gjykatave për vitin 2015 dhe 2016</p>	Mbledhja e 254, në të cilën në mënyrë të rregullt është vlerësuar puna e gjyqtarëve për vitin 2015 dhe 2016, ishte e mbyllur për publikun.
Qershor	3	<p>-Transferimi i përkohshëm për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gjyqtarit nga Gjykata Themelore Koçani në Gjykatën Themelore Dellçeve, për një periudhë prej më së paku 1 viti nga dita e transferimit dhe Gjyqtarit nga Gjykata Themelore Strumicë në Gjykatën Themelore Berovë, për një periudhë prej më së shumti 6 muaj nga dita e transferimit <p>Ndërprerja e funksionit të gjyqtarit-porotë.</p> <p>Ndërprerja e funksionit të gjyqtarit për shkak të mbushjes së moshës 64 vjeçare.</p> <p>- Shqyrtimi dhe vendimmarrja sipas kërkesave të paraqitura për rivlerësimin e punës së gjyqtarëve për vitin 2015 dhe 2016.</p>	<p>Mbledhja e 257 ishte e mbyllur për publikun në të cilën në mënyrë të rregullt u vlerësua puna e kryetarëve të gjykatave në RM.</p> <p>Të mbyllura për publikun ishin edhe pikat e rendit të ditës sipas kërkesave të paraqitura për rivlerësimin e punës së gjyqtarëve për vitin 2015 dhe 2016.</p>
Korrik	2	<p>-Publikimi i Konkursit për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, edhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gjykata e Apelit Shtip; Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup; Gjykata Themelore Kumanovë; Gjykata Themelore Tetovë; Gjykata Themelore Dibër dhe Gjykata Themelore Resnjë. <p>Publikimi i Konkursit për zgjedhjen e gjyqtarëve, edhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2 (dy) gjyqtarë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë për fushën penale; 4 (katër) gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkup – 2 (dy) për fushën penale dhe 2 (dy) për fushën e civile dhe 1 (një) gjyqtar në Gjykatën e Apelit Manastir për fushën penale. <p>-Caktimi i raportuesit, nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë sipas Kërkesës së paraqitur për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit, nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.</p> <p>-Miratimi i Raportit Vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016.</p>	Vlerësimi i rregullt i punës së kryetarëve të gjykatave në Republikën e Maqedonisë për vitin 2015 dhe 2016 (vazhdim i mbledhjes).

	<p>-Zgjedhja e kryetarëve të gjykatave, edhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në Gjykatën Themelore Gjevgjeli është zgjedhur Zllata Popova, gjyqtare e Gjykatës Themelore Gjevgjeli; • Në Gjykatën Themelore Shën Nikollë është zgjedhur Todor Pop Panev, gjyqtar i Gjykatës Themelore Shën Nikollë; • Në Gjykatën Administrative është zgjedhur Burim Sejdini, gjyqtar i Gjykatës Administrative; • Në Gjykatën Themelore Krushevë është zgjedhur Domnika Zerde Kureta, gjyqtare e Gjykatës Themelore Krushevë. <p>-për Ushtrues detyre – kryetar i Gjykatës Themelore Resnjë është zgjedhur Emel Kranli Ali, gjyqtare e Gjykatës Themelore Resnjë.</p> <p>-Ndërprerja e funksionit të gjyqtarëve-porotë në Gjykatën Themelore Berovë, sipas propozimit të kryetarit të gjykatës, për shkak të skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur.</p> <p>-Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë të Gjykatës Themelore Berovë.</p> <p>-Ndërprerja e funksionit të gjyqtarëve-porotë në Gjykatën Themelore Shën Nikollë, me propozim të kryetarit të gjykatës, për shkak të skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur.</p> <p>-Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë të Gjykatës Themelore Shën Nikollë.</p> <p>-Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë të Gjykatës Themelore Radovich.</p> <p>- Transferim i përkohshëm për kryerjen e funksionit të gjyqtarit nga Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup në Gjykatën Themelore Gostivar, më së shumti për një periudhë kohore prej 1 viti nga dita e transferimit.</p> <p>-Caktimi i raportuesve, nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë sipas kërkesave të parashtruara për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit, nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.</p>
--	---

Në periudhën kohore nga muaji maj deri në korrik të vitit 2017 Këshilli Gjyqësor mbajti gjithsej 8 mbledhje. Disa pika të rendit të ditës, gjatë këtyre 3 muajve, nuk ishin të hapura për publikun, ndërkaq kryesisht kishin të bënin me vlerësimin e punës së kryetarëve të gjykata dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve. Në këtë periudhë u mbajtën mbledhje edhe për kërkesat e paraqitura nga gjyqtarët për përsëritjen e vlerësimit të punës së tyre kështu që edhe në këtë rast, mbledhjet ishin të mbyllura për publikun.

Njëra nga pikat e rendit të ditës kishin të bëjnë me Kundërshtimin e paraqitur nga gjyqtari i GJTH Gjevgjeli për shkak të mos zgjedhjes për kryetar të gjykatës. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor vendosën të mos e shqyrtojnë kundërshtimin, meqë sipas Ligjit, Këshilli Gjyqësor nuk është kompetent të vendos në lidhje me kundërshtimin për mos zgjedhje. Njëri nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor theksoi se edhe pse nuk kanë kompetencë për të vendosur sipas kundërshtimeve, megjithatë, për shkak të sigurimit të transparencës së punës, do të duhej ta lexojnë kundërshtimin dhe ta justifikojnë dhe arsyetojnë zgjedhjen. Megjithatë, ky propozim nuk u pranua nga anëtarët e tjerë të KGJRM dhe kundërshtimi u refuzua pa e diskutuar përmbajtjen e tij.

Më datë 3 korrik, Këshilli Gjyqësor e miratoi Raportin vjetor për punën e KGJRM për vitin 2016. Për dallim nga viti i kaluar, kur nuk u pranua asnjë propozim konstruktiv të cilët u propozuan për plotësimin e Raportit të punës së KGJRM për vitin 2015, anëtarët e Këshillit Gjyqësor në këtë mbledhje njëzëri i pranuan të gjitha propozimet për plotësimin e të njëjtit, që kishin të bëjnë me aktivitetet të cilat janë pjesë e kompetencave të KGJRM, por nuk janë numëruar si elemente të cilët duhet t'i përmbaj Raporti.⁵

Kryetari i Këshillit Gjyqësor, i cili njëherësh është edhe kryetar i Këshillit Buxhetor Gjyqësor, e theksoi problemin e rishikimit të buxhetit dhe shkurtimin e mjeteve për pushtetin gjyqësor. Mes tjerash, u theksua se edhe krahas faktit se për çdo vit ballafaqohen me mjete të reduktuara, shkurtimi është tërësisht në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Buxhetor Gjyqësor dhe e vë në pikëpyetje funksionimin normal të gjykatave.⁶

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	
Raporte vjetore	Sipas Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RM, Këshilli Gjyqësor përpilon raport vjetor për punën e tij, këshilli Gjyqësor duhet të paraqes Raport deri te Kuvendi i RM për shqyrtim dhe miratim. Këshilli Gjyqësor Raportin duhet t'ua dërgoj të gjitha gjykatave të RM. Raporti duhet të jetë publik.

Këshilli Gjyqësor e paraqiti Raportin për vitin 2016 deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në muajin korrik 2017.

Kuvendi akoma nuk e ka shqyrtuar Raportin.

5 Rezyme nga monitorimi i mbledhjes së Këshillit Gjyqësor të RM - 3 korrik 2017, I aksesshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=229>

6 Neni 4 i Ligjit për buxhetin gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60, 2003. Ndryshime dhe plotësime 37/06, 103/08 dhe 145/2010. "Pjesa e mjeteve "Pushteti gjyqësor" në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, të nevojshme për funksionimin e njërive-shfrytëzuese, përcaktohet në shumë prej më së paku 0,8% nga bruto prodhimi vendor, ndërkaq në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli Buxhetor Gjyqësor, në bazë të politikës fiskale dhe parametrave kryesorë për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në rast të rishikimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nuk mund të zvogëlohen mjetet e dedikuara për financimin e pushtetit gjyqësor."

EFEKTIVITETI I PUNËS SË KGJRM

Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve

Këshilli zgjedh gjyqtar të gjykatës themelore nga rank-lista e kandidatëve të paraqitur nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publik të cilët janë paraqitur në konkurs.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka zgjedhje të gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe gjykatat më të larta. Këshilli Gjyqësor gjatë kësaj periudhe shpalli konkurse për zgjedhjen e gjyqtarëve, si vijon:

- 2 (dy) gjyqtarë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, nga fusha penale;
- 4 (katër) gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkup – 2 (dy) nga fusha penale dhe 2 (dy) nga fusha civile dhe
- 1 (një) gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Manastir, nga fusha penale.

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave	
Zgjedhja:	<p>Janë miratuar vendime për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, edhe atë të:</p> <ul style="list-style-type: none">• Gjykatës Themelore Gjevgjeli• Gjykatës Themelore Shën Nikollë• Gjykatës Administrative• Gjykatës Themelore Krushevë• Ushtrues detyre – Kryetar i Gjykatës Themelore Resnjë <p>Për të gjitha pozitat u shpall konkursi.⁷ Nuk u zgjodh vetëm kryetari i Gjykatës Themelore Kumanovë sepse kandidatët nuk e fituan shumicën e nevojshme nga KGJRM.</p> <p>Në këtë periudhë kohore Këshilli Gjyqësor shpalli konkurs për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, si vijojnë:</p> <p>Gjykata e Apelit Shtip; Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup; Gjykata Themelore Kumanovë; Gjykata Themelore Tetovë; Gjykata Themelore Dibër dhe Gjykat Themelore Resnjë.⁸</p>
Lista e kriterëve	<ol style="list-style-type: none">1. Kryetari i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, nën kushte, në procedurë dhe në mënyrë siç kryhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën respektive.2. Evaluimi i programit për punën e kandidatit për kryetar (Kandidati për kryetar të gjykatës aplikimit dhe dokumenteve të tjera ia bashkëngjit programin e punës për kohëzgjatjen e mandatit).
Vërejtje të përgjithshme	<p>Për zgjedhjen e kryetarit të GJTH Kumanovë u shpall konkursi, por nuk u bë zgjedhja e asnjërit nga kandidatët e paraqitur, sepse kandidatët me numër më të madh të pikëve nuk e fituan shumicën e votave nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor të RM, edhe pse kandidatët i plotësonin kushtet. Sa i përket votimit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për mos zgjedhjen e kandidatëve nuk pat kurrfarë diskutimi, e as arsyetimi.</p>

7 Në ueb faqen www.sud.mk në pjesën Këshilli Gjyqësor i RM. I aksesshëm në: <http://bit.ly/2v160IZ>.

8 Konkursi është i aksesshëm në: <http://bit.ly/2uF8G2g>

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave	
	Numri i procedurave
Maj-korrik 2017	/
Vërejtje të përgjithshme	Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka të dhëna për shkarkimin e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave. Vetëm Këshilli Gjyqësor caktoi raportues nga radhët e anëtarëve të KGJRM sipas kërkesave të paraqitura për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.

Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë

Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë	
Numri i gjyqtarëve-porotë	Konform Vendimit të KGJRM për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve-porotë në të gjitha gjykatat për vitin 2015 janë parashikuar 1173 gjyqtarë-porotë
Vërejtje të përgjithshme	Gjatë kësaj periudhe kohore Këshilli Gjyqësor disa herë konstatoi zgjedhje dhe ndërprerje të funksionit të gjyqtarit-porotë në më shumë gjykata të shtetit. Si problem kryesor gjatë çdo zgjedhjeje konstatohet mungesa e gjyqtarëve-porotë dhe numri i pamjaftueshëm i kandidatëve të cilët paraqiten në konkurse për zgjedhje të gjyqtarit-porotë.

Këshilli Gjyqësor i RM gjatë kësaj periudhe vendoste sipas Kërkesës së kryetarit të gjykatës themelore për ndërprerjen e funksionit gjyqtar-porotë, e cila ishte paraqitur sipas kërkesës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) për shkak se gjyqtari-porotë njëkohësisht ka qenë edhe udhëheqës i institucionit shëndetësor, gjë që nënkupton konflikt të interesit. Kryetari i Këshillit Gjyqësor theksoi se "...kërkesat e KSHPK për kufizimin e kryerjes së funksionit gjyqtarë-porotë për shkak të konfliktit të interesit janë tepër kufizuese, meqë do të çojnë deri në situatë më të keqe se situata aktuale, përkatësisht do të çojnë deri aty sa të mos ketë kandidatë të mjaftueshëm për gjyqtarë-porotë. Përveç drejtorëve, mund të ndodh të kenë aksione në ndonjë ndërmarrje dhe ngjashëm... Me vet faktin se gjyqtarë-porotë mund të jenë vetëm persona deri në moshën 64 vjeçare me arsim të kryer të lartë, do të vijmë në situatë që të paraqiten vetëm personat e papunësuar me fakultet të kryer, megjithatë, duke e marrë parasysh kompensimin financiar, i cili është shumë i ulët, do të ketë mungesë të gjyqtarëve-porotë."

Këshilli Gjyqësor i RM publikoi disa konkurse për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Në Gjykatën Themelore Kumanovë nuk u zgjodh kryetari sepse kandidatët e paraqitur nuk e fituan shumicën e nevojshme të votave. Vendimi i këtillë nuk u arsyetua.

Mbledhja për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, e datës 3 korrik 2017, kishte dallim kualitativ nga mbledhjet paraprake për zgjedhjen e kryetarëve: u lexuan biografitë e secilit kandidat veç e veç, pastaj anëtarët e KGJRM dhanë komentet e tyre për kandidatët e paraqitur për kryetar. Për dallim nga praktika e deritanishme, kur tregohet numri i pikëve të fituara nga vlerësimi i gjyqtarëve për vitin 2015/2016, në këtë mbledhje pati edhe prezantim kualitativ të kandidatëve. Fillimisht u miratua rank-lista për çdo vend të kryetarit, ndërsa më pas, në bazë të pikëve të fituara, kandidati i cili kishte numër më të madh të pikëve gjatë vlerësimit të fundit u propozua të zgjidhet për kryetar të gjykatës. Në të gjitha rastet, KGJRM e propozoi dhe e zgjodhi kandidatin i cili kishte numër më të madh të pikëve, pa marrë parasysh madhësinë e stazhit gjyqësor të kandidatëve, duke iu përmbajtur ekskluzivisht kritereve ligjore.

Megjithatë, vendimet për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave nga 3 muajt e kaluar, të cilët janë publikuar në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor, përmbajnë informacione vetëm për biografinë e kandidatit të zgjedhur, si për shembull: vitet e stazhit gjyqësor, fushën në të cilën janë specializuar dhe pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare. Të dhënat e këtilla nuk janë të aksesshme për kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur.

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve	
Numri i gjyqtarëve të transferuar përkohësisht	Numri i gjyqtarëve të transferuar përkohësisht për periudhën kohore jo më gjatë se 1 vit
	Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve nga 3 gjykata
Sa nga transferimet e përkohshme kanë qenë kundër vullnetit të gjyqtarit	/
Vërejtje të përgjithshme	<p>Vendim për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit për kryerjen e funksionit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjyqtarit nga Gjkata Themelore Koçan në Gjykatën Themelore Dellçevë, për një periudhë kohore prej më së shumti 1 viti nga dita e transferimit dhe • gjyqtarit nga Gjkata Themelore Strumicë në Gjykatën Themelore Berovë, për një periudhë kohore prej më së shumti 6 muajsh nga dita e transferimit. • gjyqtarit nga Gjkata Themelore Shkup 1 Shkup në Gjykatën Themelore Gostivar, për një periudhë kohore prej më së shumti 1 viti nga dita e transferimit <p>Në lidhje me transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve kishte diskutime se në këtë pjesë janë të nevojshme ndryshime ligjore, përkatësisht u theksua se ky problem përsëritet dhe se duhet të gjendet mënyrë për zgjidhjen e tij. Duhet të përgatitet një analizë e plotë për nevojën për gjyqtarë në të gjitha gjykatat, si dhe për zvogëlimin eventuale të numrit në disa gjykata, meqë situata aktuale e vë në dukje se KGJRM ka nevojë të vazhdueshme për transferim të përkohshëm, njëkohësisht vazhdimisht kërkohet vazhdimi i transferimit në gjykatat e njëjta, ndonjëherë edhe për gjyqtarët e njëjtë.</p>

Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e Këshillit Gjyqësor:

- Transparenca në lidhje me zgjedhjen, avancimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve është kriter thelbësor për sigurimin e gjyqësorit të pavarur dhe për sigurimin e besimit të qytetarëve ndaj gjyqësorit.

Rekomandohet portali www.sud.mk, në pjesën e Këshillit Gjyqësor të RM, të plotësohet në të gjitha fushat me informacione relevante të cilat do të jenë lehtësisht të aksesshme, ndërsa dokumentet të radhiten sipas datës së publikimit.

Këshilli Gjyqësor duhet të mbaj llogari që gjyqtari i cili zgjidhet në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës të promovoj standarde të larta të sjelljes së gjyqtarit, me një qëllim të vetëm që të fuqizohet besimi i publikut në gjyqësorin i cili është një element thelbësor për sigurimin e gjyqësorit të pavarur.

Gjatë publikimit të vendimeve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave Këshilli Gjyqësor duhet t'i arsyetoj pikat, vitet e stazhit dhe programin e punës, si për kandidatin e zgjedhur ashtu edhe për kandidatët e tjerë të cilët nuk janë zgjedhur, me qëllim që të arsyetohet zgjedhja dhe të fuqizohet besimi i qytetarëve në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe të kryetarëve të gjykatave.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve

Këshilli i Fakteve **nuk ka ueb faqe të vet** meqë Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk ka realizuar prokurim përkatës për këtë. Këshilli i Fakteve raportet për punën e vet i dërgon përmes postës elektronike deri te mediat dhe deri te Instituti për të Drejtat e Njeriut. Në periudhën e kaluar, veçanërisht në dokumentin strategjik të Qeverisë, theksohet suspendimi i këtij trupi.⁹

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë		
Karakteristika të përgjithshme për transparencën e institucionit	A posedon Këshilli i Fakteve rregulla për komunikim me publikun?	A ka angazhuar person për t'iu përgjigjur kërkesave konform qasjes së lirë deri te informacionet?
	√	√
Informimi proaktiv i publikut	Akte/të dhëna të publikuara të plota	Vërejtje të përgjithshme
Pres-konferenca	x	Këshilli i Fakteve, në këtë periudhë kohore, nuk ka mbajtur pres-konferencë për ta informuar publikun.
Komunikata	x	/
Intervista dhe deklarata për media	√x	Kryetari i Këshillit të Fakteve përmes komunikatave komunikonte me publikun.

Raporti gjysmë vjetor për punën e Këshillit të Fakteve për periudhën kohore nga 1 janari deri 30 qershor të vitit 2017 u miratua më datë 11.7.2017 dhe u është dërguar të gjitha mediave për njoftimin e tyre, si dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut më datë 11.7.2017.

⁹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Plani 3-6-9, në pjesën e reformave gjyqësore. I aksesshëm në: <http://vlada.mk>.

EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FAKTEVE

Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Edhe pse, sipas Ligjit, mbledhjet e Këshillit të Fakteve janë të hapura për publikun, publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit, për shkak të mbrojtjes së autoritetit dhe integritetit të gjyqarit ose të kandidatit për gjyqtar. Megjithatë, në praktikë **mbledhjet janë të fshehta**, meqë edhe sipas Rregullores së punës, procedura për ngritjen e përgjegjësive të gjyqarit nuk është publike.

Në këtë periudhë nuk është mbajtur **mbledhje publike**.

Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqarit deri te Këshilli i Fakteve

Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqarit deri te Këshilli i Fakteve			
	Maj	Qershor	Korrik
Numri i parashtrësive të paraqitura nga qytetarët, personat juridikë në nivel mujor	35	42	38
Mbledhje të mbajtura të Këshillit të Fakteve në të cilat është diskutuar për parashtrësit e paraqitura	6	6	2
Kërkesa për ngritjen e përgjegjësive të gjyqarit ose të kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor i RM-së	Në periudhën maj - korrik deri Këshillit Gjyqësor janë inicuar dy kërkesa për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive të një gjyqtar ose kryetar të gjykatës tek Këshilli Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.		
	Maj	Qershor	Korrik
Aktivite sipas zërit të dëgjuar	Në periudhën maj - korrik deri Këshillit Gjyqësor janë inicuar dy kërkesa për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive të një gjyqtar ose kryetar të gjykatës tek Këshilli Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.		
	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3
Kërkesa për ngritjen e përgjegjësive sipas të dhënave nga zëri i dëgjuar	Gjatë kësaj periudhe, iniciativat u inicuan nga Këshilli i fakteve nga zëri i arritur dhe ka marrë informata, por për asnjë nga këto raste nuk u inicua procedura para Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.		
Vërejtje të përgjithshme			

Nga iniciativat e paraqitura deri te Këshilli i Fakteve, numri më i madh i tyre ka të bëjë me parregullsi në punën e gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup, pasojnë iniciativat për parregullshmëri në punën e gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup dhe nga Gjykata Themelore Ohër.

Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit të Fakteve:

Nevojitet që Këshilli i Fakteve të posedojë faqe të vet të internetit, në të cilën do t'i publikoj aktivitetet e veta. Është e dobishme që Këshilli i Fakteve të përfshihet në platformën e përbashkët të re të gjyqësorit www.sud.mk.

Nëse ky organ suspendohet, atëherë duhet të sigurohet ndarja e procedurave për përgjegjësi disiplinore dhe për shkarkim para Këshillit Gjyqësor.

Procedura paraprake e inicimit dhe vendimmarrjes nga Këshilli Gjyqësor ishte vërejtja kryesore e GREGO sipas pikës 169¹⁰ që ka të bëjë me nevojën që procedura disiplinore për gjyqtarë të revidohet në atë mënyrë që shkeljet të jenë lëndë të procedurës së veçantë disiplinore. Duke i pasur parasysh parimet e pavarësisë gjyqësore, trupi i cili do ta inicioj procedurën dhe do ta zhvilloj hetimin lidhur me procedurën disiplinore rekomandohet të jetë i ndarë nga trupi i cili do të vendos për sanksionet.¹¹

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve u formua me qëllim që të sigurohet procedurë në dy shkallë gjatë procedurës disiplinore. Megjithatë, Ligji u miratua me procedurë të shkurtër dhe pa u harmonizuar me Kushtetutën e RM. Kjo kontribuoi që të ketë reagime nga publiku ekspert, si dhe kritika nga Komisioni i Venecias.¹²

10 GRECO-Group of States against Corruption, Raporti i GREKO [https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4\(2013\)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf](https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4(2013)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf), f. 39.

11 Ibid.

12 Jurisprudenca dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë, "Rrjeti 23", Komiteti i Helsinkit, 2015.

Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi aplikacion mobil për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor. Aplikacionin mund ta shkarkoni FALAS në Google Play Store dhe në Apple Store me emrin "Судски совет под лупа". Këtu do t'i gjeni të gjitha informacionet rrjedhëse dhe raportet tremujore të hartuara në kuadër të Projektit "Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM".

